URDHËR
Nr. 47, datë 14.1.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Për shkak të angazhimeve zyrtare jashtë vendit dhe për të garantuar vijimësinë e veprimtarisë administrative të Ministrisë, delegoj të drejtën e firmës për të gjitha dokumentet dhe aktet që lidhen me procedurat e importeve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit, z. Fatmir Guri, për datat 14, 15, 16 janar 2026.
2. Zëvendësministri i përmendur në pikën 1 është i autorizuar të nënshkruajë në emër të ministrit dokumentet që lidhen me importet, si më poshtë:
- kërkesat dhe miratimet për importe sipas kompetencës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- autorizimet, vërtetimet dhe shkresat zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore dhe subjekteve private për çështje që lidhen me importet;
- çdo dokument tjetër administrativ që kërkon firmën e ministrit në fushën e importeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Ky delegim është i vlefshëm vetëm për datat 14, 15, 16 janar 2026. Pas kësaj date, e drejta e firmës kthehet te ministri sipas kompetencave të tij të plota ligjore.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative, drejtoria përgjegjëse për importet dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
5. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv-protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla